V E N D I M
Nr.233, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË BASHKIMI PËR TË DREJTAT E NJERIUT, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gaspër Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

O B J E K T:Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

BAZA LIGJORE: Neni 18 pika 4 i ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.793, datë 4.6.2001 "Për regjistrimin e listës shumemërore të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicioni të partive, në bazë të përqindjes që Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 3 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 3.

Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, me shkresën nr.508, prot. datë 1.8.2001, ka vënë në dijeni Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për dorëheqjet që kanë dhënë nga kandidimi për deputet nga lista shumemërore 23 kandidatë të kësaj partie si më poshtë:

1. z. Ligoraq Karamelo
2. z. Kristo Goçi
3. z. Ziso Lluci
4. z. Leonard Solis
5. z. Gjergji Leka
6. z. Bajram Cena
7. z. Millan Vaso
8. z. Resul Domi
9. z. Vasil Bollano
10. z. Skënder Veliu
11. z. Vasil Jatru
12. z. Fuat Mehmeti
13. znj. Enkeleda Çela
14. z. Panajot Papa
15. znj.Tania Floqi

16. znj. Anita Gjoni
17. z. Anastas Buneci
18. z. Istref Pëllumbi
19. z. Jorgo Pandazo
20. z. Vladimir Verushi
21. z. Ibrahim Likzelia
22. z. Ilmi Ademi
23. z. Gjovalin Valca

Duke qenë se numri 1 dhe 2 i listës shumemërore nuk ndryshojnë, pas dorëheqjeve të paraqitura nga z. Arben Broja, i cili ka numrin rendor 25, llogaritet i treti në listën shumemërore të kandidatëve për deputetë të kësaj partie.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001 si vijon:

1. z. Vasil Melo
2. z. Vangjel Dule
3. z. Arben Broja

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gaspër Kokaj	Ilirjan Celibashi